



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Shqyrtimi i Feed-in Tarifës për Hidrocentralet e Vogla – Përgjigje ndaj Komenteve

19 Nëntor 2008

DEKLARATË

Këto përgjigje janë përgatitur nga ZRRE-ja vetëm për qëllime informative. Ky nuk është dokument vendosës dhe nuk duhet të konsiderohet se përfaqëson ndonjë vendim të ZRRE-së.

Përmbajtja

1	Hyrje	2
2	Përmbledhje e amendamenteve të propozimeve preliminare të ZRRE-së	3
3	Komentet e KEK-SHA	3
3.1	Furnizimi tepriçë nga HCV-të Prill deri në Qershor	3
3.2	Adoptimi i Kostos nga vendet e tjera	3
3.3	Kosto e Evituar	4
3.4	Rritja e çmimeve të ndërtimit	4
3.5	Diferenca e çmimeve në mes të kategorive	4
4	Komentet e KOSTT-SHA	5
4.1	Baza Ligjore	5
4.2	Krahasueshmëria e çmimeve	5
4.3	Baza e rregulluar e aseteve	6
4.4	Kosto e Personelit	6
5	Komentet e MEM-it	7
5.1	Rritja e çmimeve të investimeve kapitale	7
5.2	Tarifat nxitëse	7
6	Draft propozimi final i ZRRE-së për Feed-in tarifat e HCV-e	7
6.1	Feed-in Tarifat e HCV-e	7

1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është në procesin e shqyrtimit të Feed-in Tarifës për Hidrocentralet e vogla. Më 15 Shtator 2008, ZRRE ka publikuar raportin konsultativ mbi qasjen e kalkulimit të tarifës në fjalë.

Palët e interesuara janë ftuar që të paraqesin komentet me shkrim lidhur me analizat e ZRRE-së, propozimet preliminare dhe të gjitha çështjet tjera lidhur me to. Komente janë pranuar nga :

- Korporata Energjetike e Kosovës , KEK sh.a.
- Operatori i Pavarur i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut, KOSTT sh.a.
- Shoqata Shqiptare e Energjisë dhe Mjedisit për Zhvillim të Qëndrueshëm (SHSHEMZHQ)

Përveç komenteve të pranuar me shkrim ZRRE ka pasur takime pune me përfaqësuesit e MEM-it, KEK-ut dhe përfaqësuesin e SHSHEMZHQ. Në këtë raport konsultativ janë marrë parasysh edhe komentet dhe sugjerimet e dala gjatë diskutimeve.

ZRRE falënderon të gjitha palët e interesuara për komentet e dorëzuara në DTÇ.

Kopjet e shkresave të tyre mund të shihen në web-faqen e ZRRE-së (www.ero-ks.org).

Kjo shkresë-përgjigje ofron një përmbledhje të komenteve të pranuar si dhe përgjigjen e ZRRE-së ndaj tyre. Po ashtu shpjegon modifikimet tjera që janë bërë nga propozimet preliminare të ZRRE-së. Më pastaj kjo paraqet draft propozimet finale të ZRRE-së për Feed-in tarifën e burimeve të rinovueshme ekskluzivisht për hidrocentralet e vogla. ZRRE do të marrë vendimin final mbi tarifën e aprovuar pas rishikimit të mëtutjeshëm të këtyre propozimeve nga Bordi i saj. Është qëllim i ZRRE-së që të aprovojë sa më parë që të jetë e mundur Feed-in Tarifën në mënyrë që t'u hapet rruga investitorëve privat të investojnë në Kosovë, të përmbushen caqet indikative dhe të përmbushen kërkesat me energji nga BR.

2 Përmbledhje e amendamenteve të propozimeve preliminare të ZRRE-së

Bazuar në Komentet e pranuar si dhe rishikimin e mëtejshëm intern të të hyrave të lejuara, ZRRE propozon që të bëhen këto amendamente në propozimet e saj preliminare:

1. Të dhënat numerike për investimet kapitale pranohen të rritura për masën 20-50%.
2. ZRRE propozon që tarifa nxitëse mbi koston e prodhimit për hidrocentralet me kapacitet të instaluar deri në 2MW të jetë 5 % në vend të 10%.
3. Tarifat e reja pas ndryshimeve janë:

Kapaciteti i instaluar deri në 2MW me tarifë 6.7 cent€/kWh në vend të 6.44

Kapaciteti i instaluar 2MW – 5MW me tarifë 5.9 cent€/kWh në vend të 5.02

Kapaciteti i instaluar nga 5MW – 10MW me tarifë 5.6 cent€/kWh në vend të 4.02

3 Komentet e KEK-SHA

KEK sh.a. pas 2 takimeve duke përfshirë edhe prezantimin e modelit për kalkulimin e Feed-In Tarifës, kanë dorëzuar komentet e tyre të 4-ta dhe finale të cilat kryesisht shprehin brengën e KEK-sh.a. në lidhur me:

- Furnizimi i tepërt i energjisë nga HCV-të në muajt Prill deri në Qershor
- Adaptimi i Kostos nga Vendet e Tjera
- Kosto e Evituar
- Rritja e çmimeve të ndërtimit
- Diferenca e çmimeve në mes të kategorive

3.1 Furnizimi tepërt i energjisë nga HCV-të në muajt Prill deri në Qershor

KEK sh.a. konsideron se “problemi më i rëndësishëm mund të jetë në sezonin kur ngarkesa e KEK-ut është e tej-përmbushur”. Ata shtojnë se “kërkesa për energjinë mujore zbrit dukshëm në Prill, Maj dhe Qershor, drejt së ultës në Korrik dhe pastaj ngritet prap drejt muajve të pikut Dhjetorë dhe Janar.” Kështu KEK sh.a. argumenton se për shkak të kushteve hidrologjike të Kosovës, prurjet më të mëdha të lumenjve vijnë gjatë muajve Prill – Qershor, pikërisht atëherë kur KEK sh.a. por edhe rajoni është në suficit energjetik.

ZRRE e vlerëson si të arsyeshëm argumentin se kërkesa e energjisë gjatë këtyre muajve është më e ulët , dhe se në kohën kur gjenerimi kalon konsumin, furnizuesi publik duhet të blejë energji nga HEC-et e vogla me një tarifë më të lartë në krahasim me çmimin e eksportit të gjenerimit të tepërt. Mirëpo, në anën tjetër, gjatë 9 muajve të tjerë, në kohën e pikut dhe mungesës së gjenerimit të mjaftueshëm vendor të energjisë, furnizuesi publik furnizohet me energji elektrike nga HEC-et e vogla me çmim më të ulët në krahasim me çmimin e importit (që

në vitin 2007 pësoi rritje prej 67%). Efekti hidrologjik sigurisht se ndikon në kohën e prodhimit të energjisë nga hidrocentralet, por efekti përfundimtar varet nga përqindja e energjisë që prodhohet nga HEC-et e vogla në kohën e pikut kur importohet energjia elektrike. Prandaj, meqenëse komenti i KEK sh.a. është i arsyeshëm, pamundësia e vlerësimit kuantitativ të korrelacionit në mes të intervalit kohor të prurjes së lumenjve dhe intervalit kohor të kërkesës së pikut e bënë argumentin e KEK sh.a. diskutabil. Fakti që KEK supozon se të gjitha këto hidrocentrale do të ndërtohen në të njëjtën kohë e bën edhe më të kontestueshëm argumentin e tyre. Për më tepër, Bilanci Afatgjatë i Energjisë Elektrike të Kosovës 2009-2018 parasheh rritje të kërkesës së energjisë prej 16% nga viti 2009 në vitin 2012, siç mund të vërehet në tabelën në vijim:

Konsumi i parashikuar i Energjisë Elektrike (GWh)										
	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Bruto Konsumi	5283	5583	5930	6166	6402	6605	6699	6889	6949	7149
Konsumi Shtepiak	1988	2366	2725	2817	2841	2833	2830	2887	2867	2896
Servisat	706	781	898	1051	1219	1402	1514	1620	1733	1907
Industria	814	862	923	1006	1086	1162	1232	1281	1333	1386
Humbjet KOSTT	239	185	238	217	227	232	236	242	244	251
Humbjet KEK - Dist.	684	678	672	649	674	668	651	669	587	525
Humbjet Komerciale	852	710	473	426	355	308	237	189	185	185

Krahas këtij fakti, Metodologjia tarifore e sektorit të energjisë i lejon furnizuesit publik të ardhura shtesë prej 3% mbi koston e blerjes së energjisë për mbulimin e rrezikut të parashikimit të gabuar të kërkesës.

3.2 Adaptimi i Kostos nga vendet e tjera

Më tutje në komentet e tyre, KEK sh.a. ofron alternativa të tjera të kalkulimit të tarifës Feed-In duke supozuar që të mirrën për bazë koston e investimeve të hidrocentraleve të vogla në vendet e tjera, dhe veçanërisht në Maqedoni dhe në Shqipëri. Sigurisht se ZRrE ka pasur parasysh zhvillimin e sektorit të Hidrocentraleve të vogla në rajon dhe në vendet e tjera, mirëpo metoda e adoptimit të metodologjive dhe kostove të shteteve të tjera është irelevante në rastin e hidrocentraleve ngase 70% e koston dhe tarifës së hidrocentralit varion nga rasti në rast.

3.3 Kosto e Evituar

KEK po ashtu komenton se kalkulimi i tarifës duhet të marrë parasysh koston e evituar. Kostoja e evituar nënkupton konceptin "nëse nuk do të blinim energji nga hidrocentrali X atëherë çfarë do të paguanim për energjinë e kualitetit të njëjtë, të sasisë së njëjtë në të njëjtën kohë nga ndonjë burim tjetër?" Kështu KEK supozon që tarifa e kalkuluar për HEC-et në fjalë të jetë mesatarja e çmimit të importit për 3 vitet e fundit, duke implikuar se importi është kostoja e evituar apo e shmangur nga ndërtimi i HEC-eve të vogla.

Ky lloj argumenti paraqet disa vështirësi. Njëra prej tyre është se, vlerësimi i "koston së evituar" është çështje subjektive dhe varet plotësisht nga koncepti që përdoret për të vlerësuar se cila kosto "evitohet" nga ndërtimi i HEC-eve të vogla. Një zgjidhje e mundshme është importi. Mirëpo, të thuhet se importi është kostoja e evituar nënkupton që energjia e ofruar nga HEC-et e vogla është në dispozicion në të njëjtën kohë me importin. Meqenëse asnjë nga 18 HEC-et potenciale nuk janë akumuluese, implikimi i lartpërmendur është jo-korrekt, duke e bërë komentin mbi kalkulimin e tarifës në baza të koston së evituar jo relevant. Për më tepër, Neni 46.2 i ligjit 2004/9 "Mbi Rregullatorin e Energjisë" dikton që tarifat e kapaciteteve gjeneruese

duhen vlerësuar mbi baza "të arsyeshme, jodiskriminues, të bazuara në kritere objektive dhe të vendosura në mënyrë transparente".

3.4 Rritja e çmimeve të ndërtimit

Në anën tjetër ZRrE pajtohet me komentet e KEK sh.a. se kostot e ndërtimit janë rritur si pasojë e ngritjes së çmimeve të hekurit dhe naftës. ZRrE në bashkëpunim me zyrtarët e SHSHEMZHQ kanë kryer axhustimin e duhur në mënyrë që kostot e investimit të jenë në harmoni me ngritjen e çmimeve të investimit fillestar.

3.5 Diferenca e çmimeve në mes të kategorive

ZRrE po ashtu e konsideron të saktë komentin se diferenca e çmimeve në mes të kategorive duhet zvogëluar ngase kjo mund të shërbejë si masë nxitëse për ndërtimin e hidrocentraleve më të vogla ku është paraparë hidrocentral më i madh. ZRrE vëren se raporti konsultativ nuk ka qenë mjaft konciz në shqyrtimin e kësaj çështjeje. ZRrE shton se tarifat e publikuara vlejné për kapacitetin e lokacionit, siç është vlerësuar në studimin e SHSHEMZHQ.

4 Komentet e KOSTT-SH.A.

KOSTT sh.a. ka dërguar komente lidhur me çështjet në vijim:

- KOSTT-i mendon se ky Raport nuk jep elemente të mjaftueshme për të kuptuar arsyen e lëshimit të këtij raporti nga ZRRE-ja pasi në dokumentin e prezantuar mungon baza ligjore, andaj edhe krijohen paqartësitë dhe konfuzioni.
- Konstatimi se të gjitha hidrocentralet janë të arsyeshme nëse kanë çmimin më të ulët se importi mund të jetë e natyrës së përkohshme dhe kjo nuk duhet të shërbejë si bazë për vlerësimin e tarifës së avancuar ("feed-in tariff"). Ky konstatim në vazhdim të demantohet në pikën 4.1 të këtij dokumenti. Realisht krahasimi në çmim i importit aktual dhe energjisë që mund të ishte prodhuar nga HC në fjalë duhet të i referohet kualitetit që ato paraqesin në një treg aty për aty. Më e afërt krahasimi me çmimet e eksportit që KEK-u realizon nga gjeneratorët e vet.)
- KOSTT- sh.a. mendon se RAB-i fillestar të jetë barazi me RAB përfundimtar.
- KOSTT sh.a. komenton se mënyra e vlerësimit të kostos së personelit bazohet në 3 pika për të gjitha 18 HEC-et.

4.1 Baza Ligjore

Letra përcjellëse e raportit konsultativ të publikuar nga ZRrE përmban dispozitat ligjore në fuqi në të cilat është bazuar ZRrE.

4.2 Krahasueshmëria e çmimeve

Pika 2.2 e raportit konsultativ e titulluar "Përzgjedhja e Hidrocentraleve të përfshira në tarife" thekson mes tjerash "Fillimisht të arsyeshme janë konsideruar të gjitha ato hidrocentrale të cilat

prodhojnë energji me tarifë baraz me ose nën çmimin e importit, duke akumuluar një gjenerim vendor prej 291.67 GWh". Po ashtu Raporti konsultativ thekson se *"meqë sasia e kërkuar e energjisë së prodhuar nga hidrocentralet e vogla në udhëzimin administrativ është vetëm 145.03 GWh në vitin 2009, energjia e gjeneruar në Kosovë me rastin e ndërtimit të të gjitha hidrocentraleve të vogla, tejkalon këtë cak indikativ. Prandaj, hidrocentralet të cilat favorizohen në kalkulimin e tarifës për energji elektrike janë ato të cilat me tarifën më të ulët dhe fizibilitetin më të madh përmbushin cakun indikativ të lartpërmendur."*

4.3 Baza e rregulluar e asetëve

Baza e Asetëve të Rregulluara (BAR), paraqet shumën e kapitalit të investuar nga aksionarët , në të cilën lejohet rendimenti (kthimi) dhe zhvlerësimi vjetor në përcaktimin e të Ardhurave të lejuara vjetore.. Kjo përbëhet prej tre elementeve:

- BAR hapës apo fillestar.
- Investimet kapitale shtesë në BAR.
- Zhvlerësimi i asetëve të larguara prej BAR.

Pra ZRRE nuk pajtohet me KOSTT-SH.A në thënien se BAR-i fillestar është barazi me BAR –in përfundimtar ngase nga BAR-i fillestar zbritet zhvlerësimi i llogaritur vjetor duke përdorur metoda drejtvizore dhe shtohen investimet kapitale që kanë ndodhur gjatë vitit, dhe kështu kalkullohet BAR-i përfundimtar .

4.4 Kosto e Personelit

Në pikën 3.4.1.1 "Kosto e Personelit", KOSTT komenton se *"Kjo metodologji i përcaktimit të kostove të stafit si një vlerë e cila mund të ndryshoj linearisht ndoshta ka shërbyer në vlerë por ashtu si sqarohet tabela e çmimeve në pikën 4.2 janë zgjedhur tri pika të drejtëzës në diagramin e mëposhtëm .Ndoshta duhet sqaruar kjo se duke vlerësuar këto kosto se si është përvetësuar për nivelet e tarifave të avancuara të propozuar."* Sa për sqarim, Kosto e Personelit qe figuron ne Grafikon 1 dhe ekuacioni 8 që pasqyron drejtëzën në figurën 1, janë vetëm aplikacion i ekuacionit të drejtëzës lineare:

$$y_2 - y_1 = m(x_2 - x_1)$$

Studimi i MEM vlerëson se kosto e personelit nuk varet shumë nga kapaciteti i instaluar dhe sillet në mes të €45,000 dhe €60,000. Në rastin konkret, hidrocentralit më të vogël, atij të Bajskës i i cili ka kapacitet 300 kW, i shoqërohet kostoja e personelit prej 45,000€. Hidrocentralit më të madh, atij të Deçanit, kapaciteti i instaluar i të cilit është 8300kW i shoqërohet kosto maksimale prej 60,000€. Duke zëvendësuar këto dy pika në ekuacionin e drejtëzës, fitohet ekuacioni:

$$y = \left(\frac{15}{8}\right)x + 44,437.5, \text{ ku } y = \text{Kostoja e Personelit dhe } x = \text{Kapaciteti i Instaluar}$$

Ose siç është paraqitur në raportin konsultativ:

$$KP = \left(\frac{15}{8}\right)KI + 44,438$$

Kosto e personelit për të gjitha hidrocentralet me kapacitet të instaluar në mes të 300kW dhe 8300kW është gjetur duke zëvendësuar variablën X në ekuacionin e lartpërmendur me kapacitetin e instaluar të hidrocentralit përkatës.

5 Komentet e SHSHEMZHQ

ZRRE-ja ka pranuar një shkresë nga zyrtari i SHSHEMZHQ z. Besim Islami ku thuhet se duhet rritur investimet kapitale dhe kostove të tjera dhe rekomandon që llogaritja e tarifës të bëhet duke marrë për bazë çmimin e importit.

Në shkresë vazhdon të thuhet se:

- Te dhënat numerike për investimet kapitale të marra nga ZRRE nga studimi i SHSHEMZHQ të vitit 2006 duhet të pranohen të rritura për masën 50% sepse janë rritur çmimet e pajisjeve në tregun ndërkombëtar. Por edhe çmimet lendeve të para për veprat ndërtimore janë rritur mbase për 20%.
- 'Kostot e tjera të lejuara' duhet të pranohen me shume se 10% sepse aktualisht interesat për real estate në Kosovë janë të larta. Normat e interesit në Kosovë aktualisht janë minimumi 12%.
- Tarifa nxitëse duhet të jete me e larte për HCV me kosto me te larte dhe jo anasjelltas.

5.1 Rritja e çmimeve të Investimeve Kapitale

ZRRE pranon komentin e hartuesit i studimit të para fizibilitetit për potencialet e hidrocentraleve të vogla në Kosovë se çmimet e pajisjeve të ndërtimit fillestar në tregun ndërkombëtar janë rritur për mesatarisht 50%, dhe çmimet e lëndëve të para për veprat ndërtimore për 20%.

5.2 Tarifa nxitëse

Qëllimi i tarifës nxitëse është inkurajimi i ndërtimit i hidrocentraleve të cilat prodhojnë energji elektrike me efijencë më të lartë dhe me tarifë më të ulët, dhe jo anasjelltas.

6 Draft propozimi final i ZRRE-së për Feed-in tarifat e HCV-e

6.1 Feed-in Tarifat e HCV-e.

Pas konsiderimit të të gjitha komenteve të pranuar, tarifat e propozuara finale për Hidro centralet e vogla duken si vijon:

<i>Kapaciteti i Instaluar</i>	<i>Çmimi</i>
-------------------------------	--------------

	(€cent/kWh)
<i>Hidrocentrale deri në 2 MW</i>	6.7
<i>Hidrocentrale nga 2 MW deri në 5 MW</i>	5.9
<i>Hidrocentrale nga 5 MW deri në 10 MW</i>	5.6